



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1612/6 prot.

Datë 31 /07/2025

V E N D I M

Nr. 993 /2025

komisioni i prokurimit publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31 / 07/2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Vasaa” shpk në procedurën e prokurimit “*E hapur – e thjeshtuar*” me nr. Ref-48315-05-20-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues”, me fond limit 8,250,000.00 lekë, pa tvsh, zhvilluar në datën 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë.

Shfuqizimi i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” PF, në procedurën e prokurimit të sipërcituar si dhe lënien e të skualifikuar të operatorëve të tjerë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Vasaa” shpk me *nipt J62903470T*, adresa: *L. Kryengritja e Fierit*.

Autoriteti kontraktor:

Ndërmarrja e shërbimeve publike Sarandë, Adresa : *Rruga “Adem Sheme”, Sarandë*.

Subjekti interesuar:

Operatori ekonomik “Ervin Luzi”pf, me nipt K71707007Q, me adresë : Tiranë, Kashar Yrshek, Lagjia Katund i ri, Rruga “Ali Pash Gucia”, godina nr. 5.

Operatori ekonomik “Mifeel” shpk me nipt L82916601N me adresë : Gjirokastër Lagjia “18 Shtatori studenti ” objekti nr 27/6.

Operatori ekonomik “Nika Trading Sa” shpk me nipt M13817805J me adresë: Vlore, Sarandë, Lagjia nr.4, Rruga Idriz Alidhima, godina nr.5, kati parë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21-05-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E Hapur – e thjeshtuar” me Nr. REF-48315-05-20-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per mirembajtjen e rrjetit ekzistues”, me fond limit 8,250,000.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Sarandë.

II.2. Në datën 09-06-2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

II.3 Në datën 13.06.2025 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. “NIKA TRADING SA” SHPK	5.641.400	lekë	Skualifikuar
2. “VASAA” SHPK	6.628.000	lekë	Skualifikuar
3. “MIFEEL” SHPK	6.237.700	lekë	Skualifikuar
4. “SOFIA MYFTARI” PF	7.190.000	lekë	Skualifikuar
5. “Ervin Luzi” PF	7.240.000	lekë	Kualifikuar

II.4. Në datën 18.06.2025 Autoriteti Kontraktor ka publikuar Njoftim fituesin paraprak e procedurës së prokurimit në sistemin të prokurimeve elektronike (S.P.E.).

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimi A/2025/5453, datë 23.06.2025 dhe me nr.1612/2025 Prot., dhe protokolluar me datë 23.06.2025 e operatorit ekonomik “Vasaa ”shpk , duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.6 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1612/1 prot., datë 24.06.2025, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me arsyet e skualifikimit të

ofertës së paraqitur nga ankimuesi si dhe pretendimet mbi oferten e paraqitur nga operatori ekonomik Ervin Luzi pf.

II.7 Më datë 02.07.2025 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë , nëpërmjet shkresës me nr. 1612/3, datë 02.07.2025, me objekt *“Dergim vendimi për procedurën e prokurimit me objekt Blerje materiale elektrike per mirembajtjen e rrjetit ekzitues.”*, në lidhje me vlerësimin ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik “Vasaa” shpk, për procedurën objekt – ankimi, ku rezulton se nuk e ka pranuar ankesën e paraqitur.

II.8. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga operatori ekonomik “Vasaa” shpk me nr.1612/2 prot., datë 01.07.2025 nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Vasaa” shpk , mbi vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, me arsyet se:

“1. “Në DST e hartuar nga Njësia e Prokurimit 2.3. Pika 2.3.4 Sipas preventivit mostra me nr. rendor 10 nuk është sipas specifikimeve teknike” në shtojcën e grafikut të sasisë si dhe në shtojcën 6 të Specifikimeve teknike , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në shtojcën 6 “Specifikimet teknike” dhe 8, pika 2.3.4 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. Kriteret e veçanta të kualifikimit

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese Mostra per artikujt me nr.rendor ne preventiv nga 1-4, 8-11, 16-29, te cilat duhet te paraqiten ditën e hapjes se ofertave (date 09.06.2025, ora 10.00)

Mosdorezimi i mostrave ne momentin e hapjes se ofertave, eshte kusht per skualifikim, të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

PREVENTIV

OBJEKTI: Blerje materiale per mirembajtjen e rrjetit ekzistues
INVESTITOR: Ndermarrja e Sherbimeve Publike Bashkia Sarande

NR	MATERIALE ELEKTRIKE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLEFTA
1	Llampa 150w xokol te madhe me drosel (original) te shkurtra	cope	150		
2	Llampa 250w xokol te madhe alogjene me drosel (original) te shkurtra	cope	150		
3	Llamba led 30-40 w, 4000k	cope	400		
4	Llamba led 3000k 220v 4w me filament	cope	100		
5	Varg me portollamba I gomuar plastik/baker	ml	100		
6	Portollamba me xokol te madhe E 40 per koka ndricimi	cope	30		
7	Portollamba me xokol te vogel E 27 plastike	cope	100		
8	Drosel 250w me dy kontakte	cope	110		
9	Drosel 150w me dy kontakte	cope	110		
10	Ndrices Led me panel diellor 60-100w	cope	50		
11	Ndrices Led 100 w	cope	200		
12	Krah shtylle per ndricuesat f60 (Braceta Te galvanizuara)	cope	100		
13	Drajver per koka led Tipi 1 sipas fotos ne specifikime	cope	50		
14	Drajver per koka led Tipi 2 sipas fotos ne specifikime	cope	50		
15	Drajver per koka led Tipi 3 sipas fotos ne specifikime	cope	50		
16	Ignajder 400V	cope	150		
17	Fotoelement	cope	100		
18	RL diferenciale 1P+N	cope	50		
19	RL diferenciale 4P 63A	cope	10		
20	Leshues 40A	cope	50		
21	Leshues 63A	cope	90		
22	Automat 100A 4P	cope	3		
23	Automat 80A 4P	cope	5		
24	Automat 63A 1P	cope	5		
25	Automat 40A 1P	cope	60		

Shtojca 6

Specifikimet teknike

Ndrices rrugor Led me panel diellor

- Diametri i fiksimit me shtyllen D=60mm.
- I pajisur me 3 pllaka ndricimi te fuqishme LED.
- Fuqia e llampes 60-100Ë.
- Tensioni i hyrjes DC 12/24V
- Paneli diellor: Paneli diellor polikristalor me efikasitet te larte te energjise 12/24V 60-100Ë
- Bateri litium e rikarikueshme me ane te panelit diellor 12/24V 100Ah
- Trup me material rezistent Aliazh alumini.
- Rezistent ndaj uji, IP65.
- Fluksi I drites 190lm/Ëatt
- Karikohet me ane te panelit diellor gjate dites dhe ndizet automatikisht naten.
- Paneli diellor i inkorporuar mundeson karikim gjate dites.
- Ndricesi: Te jete i pajisur me sensor levizjeje dhe drite.
- Paneli mundeson ndricim ne kend 180°.
- Ndricim i fuqishem LED me ngjyre te bardhe 4500-6500K.
- Paneli i pajisur me pult komandimi, per komandim ne distancë.
- Temperatura e punes T (-25/50°C)
- Përmasat : 80-98 x 30-45 x 10-15cm.
- Pesha 8-10 kg
- Jetëgjatësia >50 000(orë)
- Garancia 3 vjet
- Perdorimi rruge urbane per shtylla me lartesi 5m





► **Smart sensor**
Multifunctional microwave induction.




► **Induction range**
130° Induction angle,
10m Induction distance.



► **Smart Remote**
There are multi-working modes, you can change its working mode as you need.



► **Lumileds LEDs**
High brightness, lifetime 100000 hours.



► **Solar panel**
High-efficiency solar panel, >21% photoelectric conversion rate, special surface treatment.



► **Thickened aluminum die-casting shell**
The shell is made of ADC12 aluminum die-casting, which has high temperature resistance, anti-corrosion, effectively guarantees the service life of the lamps.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- **Skedë teknike:** e cila përmban të dhënat si në vijim, ROAD LED 100 Ë POËER 100; LUMINOUS FLUX 14600 IM 360' ;VOLTAGE 230V ; COLOR TEMPERATURE 4500 K; zhongshan Hnagzhou Lighting co ltd 15 zhulja... SZ -818-100-5054...

III.1.3. Neni 2 “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe

jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.1.6. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën

sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.7 Neni 36, i ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon se: “Specifikimet teknike”, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla

duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor. 7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7 . Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe të specifikimeve teknike, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit/mallit sa më cilësor, me qëllim realizmin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kriteret për kualifikim dhe specifikime teknike, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se, autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues duhet... 2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqesin mostra për artikujt me nr.rendor ne preventiv nga 1-4, 8-11, 16-29, të cilat duhet të paraqiten ditën e hapjes së ofertave (date 09.06.2025, ora 10.00)

Komisioni vëren se referuar raportit të auditit në SPE të autoriteti kontraktor si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Vassa” SHPK për

përmbushjen e specifikimeve teknike të sipërmendura, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin SPE si më poshtë: -Skedën teknike: *Për artikullin me nr. 10 me nr. faqesh 7 dhe fletë 7, e cila përmban të dhënat si në vijim, Road led 100 ë poëer 100; Luminoues flux 14600 im 360' ;voltage 230v ; Color temperature 4500 K; Zhongshan Hangzhou Lighting co LTD 15 zhuija... SZ -818-100-5054 nga shoqëria "Vassa" shpk. Gjithashtu referuar raportit të auditit në SPE, rezulton se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik Vassa shpk sipas raportit të auditit "Në DST e hartuar nga Njësia e Prokurimit 2.3. Pika 2.3.4 Sipas preventivit mostra me nr. rendor 10 nuk është sipas specifikimeve teknike te kerkuara".*

Komisioni konstaton, se nga ana e KVO nuk janë dhënë shpjegime në mënyrë shteruese, lidhur me mospërmbushjen e elementëve të specifikimeve teknike të sipërpërmendura në shtojcën 6 të dokumentave të tenderit nga operatori ekonomik ankimues. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, arsyes së skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar raportit të auditit në SPE, si dhe dokumentacionit të operatorit ekonomik "Vassa" SHPK , të dorëzuar në SPE, në përmbushje të specifikimeve të mësipërme, Komisioni gjykon se, është në kushte të paqarta dhe në pamundësi për të vlerësuar mbi arsyet e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, konkretisht në vlerësimin e dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, sepse ky i fundit nuk ka dhënë apo evidentuar qartë se cilët prej specifikimeve teknike nuk ka përmbushur. Në këto kushte, autoriteti kontraktor ka vënë në pozita të paqarta dhe konfuze edhe operatorin ekonomik ankimues për të argumentuar apo kundërshtuar vlerësimin e dhënë për këtë të fundit për arsyen e skualifikimit, në lidhje me mospërmbushjen e specifikimeve teknike .

Në këto kushte, Komisioni gjykon se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të rikthejë procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga statusi aktual në statusin e fazës së vlerësimit, sepse secili anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të evidentojë qartë dhe saktë, se cili specifikim nuk përmbushet nga ankimuesi në përmbushje të kriterit përcaktuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Sa më lart pretendimi i i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Vasaa" shpk , me arsye se :

"1. "Pra kualifikimi i Operatorit ' ...ERVIN LUZI ' eshte kryer ne flagrance te ligjit te LPP-se 162/2020. Si perfundim kerkojme : Kualifikimin e Firmes VASAA shpk si i vetmi operator i sukseshem pjesemarres ne procduren ne Flaje,Skualifikimin e OE ERVIN LUZI, lenien te pandryshuar si te skualifikuar te operatoreve te tjere pjesemarres n editen dhe oren e hapjes se procedures Me sy te lite pame qe operatoret Nika Trading s.a, dhe Mifeel , disa nga mostrat nuk i kishin sipas specifikimeve teknike te kerkuara dhe konkretisht : Ndricues Led me panel diellor 60-10ë, Rele diferenciale IP+N, Leshues 40A,Leshues .2 operatoret e tjere qe dorezuan oferta ne sistemin elektronik SPE , nuk ishin pjesemarres me mostra ditën dhe oren e hapjes se ofertave .Kualifikimi nga AK i Operatorit ERVIN LUZI, eshte shkelje flagrante e Ligjit 162/2020, neni 2, neni 3, udhezimet per pjesemarje te operatoreve ne Procedure Prokurimi , duke paracatuar me pare Fituesin , pavaresisht se Operatori E .Ervin Luzi nuk mori pjese ne dorezimin mostrave datën dhe oren e caktuar ne AK , mos dorezimi i te cilave perbente kusht squalifikues sipas DST-se, se Publikuar ne sistemin SPE, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1 Në shtojcën 6 “Specifikimet teknike” dhe 8, pika 2.3.4 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. Kriteret e veçanta të kualifikimit

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqese Mostra per artikujt me nr.rendor ne preventiv nga 1-4, 8-11, 16-29, te cilat duhet te paraqiten ditën e hapjes se ofertave (date 09.06.2025, ora 10.00)

Mosdorezimi i mostrave ne momentin e hapjes se ofertave, eshte kusht per skualifikim, të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III. 2.2 Neni 89 i ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon se: *“Paraqitja dhe pranimi i ofertave”, 1. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton vendin, datën dhe orën e paraqitjes së ofertave.2. Paraqitja e ofertave bëhet në një nga mënyrat e mëposhtme:a) ofertat dorëzohen në rrugë elektronike, sipas përcaktimit në aktet nënligjore; ose b) ofertat dorëzohen me shkrim, nëse një gjë e tillë është parashikuar në aktet nënligjore, dorazi ose përmes postës, të nënshkruara dhe të mbyllura në zarf.3. Në rastet kur shtyhet afati përfundimtar i pranimi të ofertave në përputhje me parashikimet e këtij ligji, njoftimi për shtyrje të këtij afati publikohet në të njëjtën mënyrë siç është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.*

III.2.10. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe të specifikimeve teknike, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit/mallit sa më cilësor, me qëllim realizmin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se, autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues duhet... 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesin mostra për artikujt me nr.rendor ne preventiv nga 1-4, 8-11, 16-29, të cilat duhet të paraqiten ditën e hapjes së ofertave (date 09.06.2025, ora 10.00)

Komisioni vëren se referuar pretendimit të operatorit ekonomik si dhe informacionit të autoriteti kontraktor të ardhur pranë KPP-së, konstaton, se autoriteti kontraktor ka paraqitur dokumentacionin e përcjellë me anë të shkresës nr. 88 prot., datë 30.06. 2025 dhe prtokolluar me tonën me nr. 1612/3, datë 02.07.2025, me objekt “ *Dergim vendimi për procedurën e prokurimit me objekt Blerje materiale elektrike per mirembajtjen e rrjetit ekzitues.*”, Komisioni pasi bëri verifikimet e dokumentacionit të përcjellë konstatoi se me anë të ‘Procesverbalit’ me datë 09.06.2025; ORA 10:05 në Ambjentet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Sarandë “*Mbi procesin e aministrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik në prezencë të subjektit Ervin Luzi pf dhe përfaqshuesve të autoritetit kontraktor u dorëzuan mostrat.....Procesverbal i cili rezulton i mbajtur ndërmjet përfaqshuesve te AK O.Z; N. M; A.D si dhe për operatorin ekonomik Ervin Luzi .*

nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor , rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përmendur për operatorin ekonomik ervin luzi pf. si dhe referuar

pretendimit e operatorit ekonomik ankimues, operatori ekonomik është në përmbushje të kriterit të kualifikimit të mësipërm parashikuar në pikën 2.3.4 2.3.4 operatori ekonomik duhet te paraqesin mostra për artikuajt me nr.rendor ne preventiv nga 1-4, 8-11, 16-29, të cilat duhet të paraqiten ditën e hapjes së ofertave (date 09.06.2025, ora 10.00).

Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues mbi operatorët e tjerë ekonomik të cilët rezultojnë të skualifikuar nga autoriteti kontraktor, komisioni vlerëson se për sa kohë statusi i tyre është i skualifikuar interesi i ligjshëm i operatorit ekonomik nuk çënohet, në këto kushte Komisioni vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk do të merret në shqyrtim.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

- 1.Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vassa” SHPK, për procedurën e prokurimit “E Hapur – e thjeshtuar” me Nr. REF-48315-05-20-2025, me objekt: “Blerje materiale elektrike per mirembajtjen e rrjetit ekzistues”, me fond limit 8,250,000.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 09-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë.
- 2.Autoriteti kontraktues të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Vassa” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit.
- 4.Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “Vassa” SHPK
- 5.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiovent Zguro

